



## PJESA 3 E LICENCËS SË KPM-së – FORMATI I PROGRAMIT

**Emri i Stacionit:**

**Indeksi i Medias:**

**I Licencuari:**

**Data:**

**1.0** Në bazë të kërkesës së Rregullores së UNMIK-ut 2000/36 që KPM-ja të merr për bazë interesat e publikut me rastin e dhënies së licencave të transmetimit, nga i Licencuari pritët që në transmetimet e tij, si një nga kushtet e Licencës, t'i përmbahet formatit dhe strukturës së përgjithshme të programit në bazë të të cilit i është dhënë Licenca dhe spektri i frekuencës. Neglizhimi i shpeshtë në zbatimin e tij mund të çojë në anulimin e Licencës.

**2.0** Nga i Licencuari kërkohet që të njoftojë paraprakisht KPM-në për ndryshime të rëndësishme të cilat ai i propozon t'i bëjë në formatin e programit siç është përcaktuar në Pjesën 3 të Licencës. KPM-ja do ta njoftojë me kohë të Licencuarin nëse këto ndryshime të propozuara janë në përputhje me interesat publike në bazë të të cilave u dha Licenca e parë, dhe nëse ato janë të tilla, do të ndryshojë Pjesën 3 në përputhje me to.

**2.1** Si ndryshim i rëndësishëm që kërkon informimin paraprak të KPM-së përcaktohet ndryshimi i një të katërtës të ndonjë kategorie të Tipit të Programit ose të Burimit të Programit, ose eliminimi i ndonjërit nga kategoritë e Tabelës 1; dhe/ose një ndryshim material në llojin dhe përmbajtjen e programit siç është përcaktuar në Tabelën 1. Ndryshime të tilla do të maten me krahasimin me sasinë e tipeve të programit dhe burimeve, dhe formatin, siç është përcaktuar në kërkesën origjinale të të Licencuarit.

### **3.0 Përkufizime:**

**3.1 Programi i Shërbimit Publik:** Programi i Shërbimit Publik përbëhet nga lajmet, diskutimet dhe intervistat për çështjet me interes publik; programet edukative aktuale për të rriturit ose fëmijët që kanë nevojë për përkrahje ose ndryshojnë bindje për tema ose modele; argëtime për fëmijë me tema edukative; dokumentarët; programet kulturore, qëllimi kryesor i të cilave është të informojnë e jo të argëtojnë.

**3.2 Programe Argëtuese:** Muzikë popullore/bashkëkohore, filma, lojëra, sport, drama dhe komedi komerciale dhe programe që lidhen me to.

**3.3 Programe të Prodhimit të Vet:** Shfaqje ose paketa programore që përfshijnë materiale argëtuese dhe ato të shërbimit publik të prodhuar dhe të paraqitur nga i Licencuari.

**3.4 Programe të Ritransmetuara:** Shfaqje ose paketa të tjera programesh të siguruara nga transmetues të tjerë vendas ose të huaj, zakonisht me satelit dhe të ritransmetuara nga i Licencuari në bazë të kontratës me prodhuesin ose emetuesin e parë.

**3.5 Programe Komerciale nga Jashtë:** Programe të marra në bazë të një kontrate të vlefshme komerciale, zakonisht në formë të regjistruar, siç janë filmat.

TABELA 1

<b>1. Tipi i programit</b>	Përqindja
1.1 Shërbimi Publik	
1.2 Argëtim:	
	Gjithsej %
<b>2. Burimi i Programit</b>	
2.1 Prodhim i veti	
2.2 Komercial nga jashtë	
2.3 Ritransmetim	
	Gjithsej %

*Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë, i Licencuari pranon dhe bie dakort me të gjitha kushtet dhe termet e përcaktuara në Pjesën 3 të kësaj Licence.*

**EMRI:**

**DATA:**

**NËNSHKRIMI:**

**I LICENCUARI:**

*Me anë të vënies së firmës këtu më poshtë nga ana e KPM-së, Pjesa 3 e kësaj Licence do të konsiderohet si e dhënë zyrtarisht dhe e vlefshme.*

**NËNSHKRIMI:**

**DATA:**

[Miratuar më: 25 prill 2005]